

## E DREJTA PËR INFORMIM

### PËRMBLEDHJE MUJORE E VENDIMEVE

**Vendim Nr. 17** - Ministria e Drejtësisë

**Vendim Nr. 18** - Departamenti i Administratës  
Publike

**Vendim Nr. 19** - Bashkia Vorë

**Vendim Nr. 20** - Ministria e Drejtësisë

**Vendim Nr. 21** - Kontrolli i Lartë i Shtetit

**Vendim Nr. 22** - Bashkia Dimal

**Vendim Nr. 23** - Bashkia Fushë-Arrëz

**Vendim Nr. 24** - Bashkia Këlcyrë

### PËRMBLEDHJE MUJORE E REKOMANDIMEVE

**Rekomandim Nr. 10** - Ujësjetllës Kanalizime Lezhë

**Rekomandim Nr. 11** - Ujësjetllës Kanalizime Pogradec

**Rekomandim Nr. 12** - Ujësjetllës Kanalizime Lushnje

**Rekomandim Nr. 13** - Ujësjetllës Kanalizime Durrës

**Rekomandim Nr. 14** - Ujësjetllës Kanalizime Berat

**Rekomandim Nr. 15** - Ujësjetllës Kanalizime Dibër

**Rekomandim Nr. 16** - Ujësjetllës Kanalizime Sarandë

**Rekomandim Nr. 17** - Ujësjetllës Kanalizime Fier

**Rekomandim Nr. 18** - Ujësjetllës Kanalizime Elbasan

**Rekomandim Nr. 19** - Ujësjetllës Kanalizime Shkodër

**Rekomandim Nr. 20** - Ujësjetllës Kanalizime Vlorë

**Rekomandim Nr. 21** - Ujësjetllës Kanalizime  
Gjirokastër

**Rekomandim Nr. 22** - Ujësjetllës Kanalizime Kukës

**Rekomandim Nr. 23** - Ujësjetllës Kanalizime Korçë

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302 datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" është bërë riorganizimi i sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura. Në vijim janë themeluar shoqëritë rajonale të ujësjetllës kanalizimeve në formën e shoqërive tregtare me shumicën e aksioneve në zotërim të shtetit.

Në pikën 1 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar përcaktohet se: "Autoritet publik" a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike".

Për rrjedhojë shoqëritë rajonale të ujësjetllës kanalizimeve konsiderohen autoritete publike, në kuptim të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar.

Referuar shkronjës f) të nenit 9/1 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale: "f) bën rekomandime për autoritetet publike lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës".

Për sa më sipër janë hartuar 14 rekomandime lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës së 14 shoqërive rajonale të ujësjetllës kanalizimeve.

# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit tetor 2024



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit tetor 2024, ka dhënë 8 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI"). Me anë të vendimit nr. 21 datë 25.10.2024, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Kontrollit të Lartë të Shtetit" (në vijim Autoriteti Publik), me objekt "Refuzim për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, ka kërkuar pranë Autoritetit Publik t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni dhe konkretisht:

- Kopje të raportit të auditimit të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Bankën e Shqipërisë të vitit 2017.

Autoriteti Publik, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke sqaruar se: "...raporti i sipërcituar nuk mund t'ju vihet në dispozicion, sepse konsiderohet ...".

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga Autoriteti Publik.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar (në vijim "LDI").

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke mbajtur të njëjtin qëndrim.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja ka vijuar, duke kërkuar urdhërimin e dhënies së dokumentacionit nga Autoriteti Publik sipas kërkesës për informacion.

Në këto kushte, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Gjatë inspektimit, grupi i inspektimit kontaktoi me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik dhe me Drejtorin e Drejtorisë Juridike pranë Autoritetit Publik, i cili nga deklarimi i koordinatores dhe dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, rezultoi se ka trajtuar kërkesën për informacion. Në vijim, Autoritetit Publik i'u kërkua që anëtarë i grupit të inspektimit, të këqyrin dokumentacionin e kërkuar. Gjithashtu, u kërkua që të vendoset në dispozicion të grupit të inspektimit, urdhri i miratimit të listës së informacioneve të klasifikuara "Sekret Shtetëror" në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga këqyrja e dokumenteve, rezultoi se nuk ndodhemi përpara procedurës së klasifikimit, por, dokumentacioni është klasifikuar si "konfidencial. Lidhur me urdhërin e miratimit të listës së informacioneve të klasifikuara "Sekret Shtetëror" nga kërkimet në arkivën e institucionit nuk u gjet një urdhër i brendshëm.

Në përfundim të inspektimit u lexua procesverbali nga të pranishmit dhe pasi u gjet i shkruar drejtë, u nënshkrua rregullisht nga të dyja palët.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesën e saj. Ndërkohë, Autoriteti Publik, depozitoi pranë Komisionerit pretendimet, duke rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur gjatë inspektimit.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara, nuk janë në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI. Komisioneri konstaton se, është bërë një interpretim të gabuar të Vendimit (të ndërmjetëm), i cili, si bazë ligjore të tij ka shkronjat "ç" dhe "k" të nenit 25 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Ndërkohë, është konsideruar dokumentacionin e kërkuar të klasifikuar si sekret, të nivelit "konfidencial", në kuptim të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të ndryshuar. Ndryshe nga sa u deklarua, gjatë shqyrtimit administrativ, nuk u provua në asnjë moment se është respektuar procedura e parashikuar në dispozitën e mësipërme. Për më tëpër, për sa i përket bazës ligjore të referuar si shkak për kufizimin e informacionit, Komisioneri vlerëson parashikimet e referuara, nuk mund të legjitimojnë titullarin e Autoritetit Publik që të klasifikojë një dokumentacion si "konfidencial", pasi, kjo procedurë rregullohet nga legjislacioni i posaçëm për informacionin e klasifikuar.

Garantimi i të drejtës për informim të dokumenteve publike, është sanksionuar nga Kushtetuta, Konventa "Për aksesin në dokumente zyrtare", ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e Informimit", i ndryshuar si dhe ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Për sa më sipër, përsa kohë procedura e klasifikimit nuk është kryer në përputhje me parashikimet e ligjit për informacionin e klasifikuar, por bazohet vetëm në vendimin e ndërmjetëm të Kryetarit të Autoritetit Publik, trajtimi i praktikës duhet të ishte bërë në zbatim të nenit 17 të LDI, pasi është kjo dispozita që parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Në këto kushte, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur në kundërshtim me LDI dhe legjislacionin e posaçëm për informacionin e klasifikuar.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave, sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, deklarimeve gjatë inspektimit dhe parashtrimeve të depozituara nga Autoriteti Publik, Komisioneri konstaton se Drejtori i Drejtorisë Juridike, ka refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në kundërshtim me LDI dhe legjislacionin e posaçëm për informacionin e klasifikuar.

Gjatë inspektimit, i'u komunikua se kërkesa është trajtuar brenda afatit të përcaktuar në LDI, duke refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar me argumentin si më sipër trajtuar. Lidhur me këtë konstatim nga ana e nëpunësit nuk u paraqit asnjë pretendim, vërtetuar kjo nga procesverbali i mbajtur.

Në këto kushte, ndaj personit përgjegjës u vendos sanksion administrativ, bazuar në shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 18 të LDI.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vendosi urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës, duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

## Zyra e Komisionerit zgjidhet anëtare në Grupin e Specialistëve të Konventës 205 të Këshillit të Evropës




Me hyrjen në fuqi në vitin 2020, Konventa 205 “Për aksesin në dokumentet zyrtare” të Këshillit të Evropës, njohur ndryshe edhe si Konventa e Tromsøs, u bë instrumenti i parë ndërkombëtar ligjor detyrues që njih të drejtën e qasjes në dokumentet zyrtare, që mbahen nga autoritetet publike. Shqipëria e nënshkroi dhe e ratifikoi Konventën në vitin 2022, duke miratuar ligjin nr. 45/2022, i cili përcakton Komisionerin

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si organin përfaqësues të Shqipërisë në Këshillin e Palëve.

Këshilli i Palëve është një nga dy organet të cilat monitorojnë zbatimin e Konventës. Ai përbëhet nga një përfaqësues nga çdo vend palë dhe ka rolin e organit vendimmarrës, i cili shqyrton opinione apo propozime që paraqiten nga Grupi i Specialistëve. Ky i fundit është organi i cili ka funksione më teknike, konkretisht me përgatitjen e opinioneve, shkëmbimit të eksperiencës për aspekte të ndryshme të aksesit në informacion, formulimin e propozimeve lidhur me zbatimin efektiv të Konventës, etj. Grupi i Specialistëve përbëhet nga 10 anëtarë të zgjedhur me një mandat 4-vjeçar, me të drejtën për rizgjedhje vetëm një herë.

Në takimin e 4-t të Këshillit të Palëve znj. Elona Hoxhaj, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, u zgjodh anëtare e Grupit të Specialistëve. Kjo tregon angazhimin dhe përpjekjet e vazhdueshme për arritjen e standardeve më të larta në fushën e të drejtës për informim të Shqipërisë, e cila bëhet pjesë e nivelit më të lartë të trupës së ekspertëve në Evropë për aksesin në informacion. Ky rol i ri e vendos Shqipërinë në zemër të lëvizjes evropiane për transparencë dhe do t'i japë mundësinë për të kontribuar në zhvillimin e politikave të kontinentit tonë, por gjithashtu përthithjen e praktikave më të mira ndërkombëtare, duke sjellë përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët e saj.



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE



# Projekti i Bashkimit Evropian për Qeverisjen e Mirë mbështet Zyrën e Komisionerit

Projekti “*Bashkimi Evropian për Qeverisjen e Mirë*” synon që nëpërmjet standardeve bashkëkohore komunitare të rrisë nivelin e transparencës në veprimtarinë e administratës publike shqiptare dhe të nxisë akoma më shumë luftën kundër korrupsionit. Zyra e Komisionerit është një nga përfituesit pjesë e Komponentit të 4-t të këtij projekti. Nga zbatimi i tij pritet forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale jo vetëm i stafit të institucionit, por edhe i autoriteteve publike dhe grupeve të interesit për zbatimin e kuadrit të modernizuar ligjor të të dy fushave të përgjegjësive.



Në mjediset e Zyrës së Komisionerit u zhvillua ceremonia e lançimit të këtij projekti, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Delegacionit të BE në Shqipëri dhe ekspertëve të tij.

Tre komponentët e projektit janë:

1. forcimi i kapaciteteve institucionale dhe koordinatorëve për të drejtën e informimit për zbatimin efektiv të ligjit nr. 45/2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare” (Konventa 205) dhe ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”;



2. ofrimi i asistencës për të garantuar zbatimin efektiv të Konventës së modernizuar të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” (Konventa 108+), përfshirë në legjislacionin shqiptar me miratimin e ligjit 49/2022;

3. mbështetje koordinatorëve për të drejtën e informimit, gjithashtu, institucioneve qendrore dhe vendore, për të përmirësuar trajtimin e kërkesave për informacion për një zbatim më efektiv të ligjit për të drejtën e informimit.

Për Zyrën e Komisionerit asistenca e BE është e rëndësishme në funksion të konsolidimit të veprimtarisë institucionale për garantimin e ushtrimit praktik të të drejtave nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike. Ky projekt është, gjithashtu, konfirmim i bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe efektiv të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri me Zyrën e Komisionerit, në kuadër edhe të procesit të integritetit, për shkak të rolit dhe kontributit kryesor që institucioni ka në këtë kontekst.

# Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile për nxitjen e pjesëmarrjes qytetare



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mikpritri një grup përfaqësuesish të organizatave të shoqërisë civile në kuadër të “Programit të Shkëmbimit të OJF”. Në fokus të këtij takimi ishte njohja me rolin dhe funksionet e institucionit dhe bashkëveprimi për nxitjen e pjesëmarrjes sa më aktive të qytetarëve dhe palëve të interesuara në vendimmarrjen e autoriteteve publike.

Pjesëmarrësit në këtë takim ishin nga shoqata/organizata të reja që e kanë selinë dhe e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Berat, Korçë, Elbasan apo dhe Tiranë. “Programi i Shkëmbimit të OJF” është nismë e Partnerët Shqipëri (Partners Albania), e cila ka për qëllim mbështetjen dhe fuqizimin e sektorit të organizatave të shoqërisë civile, kryesisht atyre lokale. Nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet publike dhe vizitave studimore synohet fuqizimi i kapaciteteve të OjF, për adresimin e duhur të problematikave të qytetarëve apo grupeve të interesit.

## Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



Komisioneri KDIMDP



IDP Albania



idp.albania



IDP Albania